

N<sup>o</sup> 653/1. Prot



dt. 15.11.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
INSPEKTORATI QENDROR

Lënda: Dhënie mendimi.

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Adresa: Rruga "e Kavajës", Tiranë

Për dijeni:

**SH.T.Z EDI RAMA**  
**KRYEMINISTËR**  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Në përgjigje të shkresës Tuaj me nr. 5304 prot., datë 07.11.2019, ku kërkohet mendim për projektvendimin, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror", parashtrojmë sa më poshtë vijon:

Shqipëria që prej vitit 2011, me mbështetjen e USAID, Bankës Botërore, është strukturuar me inspektorate shtetërore, sipas modelit *Inspektorate Shtetërore me Inspektorat Qendror* si: Bosnja-Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Sllovenia, Holanda, Franca, Britania e Madhe. Ky organizim strukturor nga 33 inspektorate në 15 inspektorate shtetërore, ka nisur të mirëfunksionojë dhe të japë efektet e para pozitive, si në klimën ndaj biznesit, ashtu edhe në mbrojtjen e interesit publik.

Inspektoratet shtetërore tashmë në Shqipëri kanë një bazë unike ligjore, e rregulluar kjo me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", duke e standardizuar të gjithë dokumentacionin e veprimtarisë inspektuese për të gjitha inspektoratet shtetërore, dhe është në proces standardizimi edhe për inspektoratet vendore.

Ligji për inspektimin ka dhënë efekte pozitive jo vetëm në procesin inspektues, por edhe ndaj biznesit, pasi është rritur transparenca, është minimizuar korrupsioni dhe çdo proces inspektimi është i gjurmueshëm në kohë reale.

Në prezantimin e programit qeverisës të vitit 2017, Kryeministri SH.T.Z Edi RAMA, me të drejtë ka artikuluar se inspektoratet janë ende të shumta në numër dhe janë kthyer në trupa klienteliste, jo-profesionale dhe duhet të ri-organizohen si struktura bazuar me objekt të ngjashëm inspektimi.

Inspektorati Qendror, ka propozuar ri-formatimin e këtyre trupave nga 15 inspektorate shtetërore, duke evidentuar dhe disa Drejtori/Agjenci me funksione të mirëfillta inspektimi, në 6-7 kolona inspektuese, me qëllim shmangien e mbivendosjeve, si dhe për një menaxhim dhe koordinim më të mirë të Inspektorateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Megjithëse propozimi i Inspektoratit Qendror për amendimin e ligjit për inspektimin, nr. 10433, datë 16.06.2011, i cili ka kaluar tashmë edhe fazën e konsultimit publik, ka pasqyruar edhe

Janë krijuar me VKM disa agjenci me funksione licencimi, akreditimi, monitorimi dhe inspektimi, dhe 2 inspektoratet shtetërore Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve Ujërave Turizmit , i janë bashkëngjitur këtyre agjencive, në konflikt të pastër interesi.

**Krijimi i agjencive, duke bashkuar stukturat e licencimit me ato të monitorimit dhe inspektimit, janë struktura që nuk kanë asnjë model të ngjashëm me vendet e BE.**

Projektvendimi për krijimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë të Kujdesit Shëndetësor, është në kundërshtim me ligjin për inspektimin, parimet e OECD, Inspektoratin e Përgjithshëm të Administratës Publike Franceze, Dhomave të Biznesit, etj., me argumentimin sa vijon:

1. Baza ligjore e projektvendimit për krijimin e Agjencisë, është në kundërshtim me nenin 11, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
2. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, funksionon si një strukturë e mirëorganizuar administrative, profesionale dhe me mandat të qartë inspektues, me varësi direkte nga ministri me fuqi të plotë inspektuese.
3. Janë zbehur parimet dhe roli i një trupe të posaçme inspektimi.
4. Me këtë lloj modeli organizimi, përshkallëzohen më tepër problemet me trupat e inspektimit.
5. Në Kap III, të projektvendimit, pika 3, gerrat nga “r-ë”, janë të përcaktuara disa detyra dhe përgjegjësi, të cilat në zbatim të ligjit për inspektimin, janë të rregulluara dhe të implementuara në sistemin “e-Inspektimi”, si: programimi, bashkërendimi, unifikimi i praktikave inspektuese, informimi, etj., të cilat janë të harmonizuara në përputhje të plotë me ligjin e inspektimit, ligjet sektoriale dhe Kodin Procedurës Administrative.
6. Veprimtaria e inspektimit është një sistem i dixhitalizuar, i cili do të dobësohet, duke bërë që disa prej trupave të inspektimit të shkojnë përtej fushës së veprimtarisë inspektuese, pasi nuk do të ketë më inspektime plotësisht të fokusuara në risk, por ato do të jenë vetëm të urdhëruara.
7. Ky ri-bashkim do të ketë ndikim më të drejtpërdrejtë të politikës jo vetëm në politikë-bërjen e kësaj agjencie, në vlerësimin e kushteve për dhënien e licencës, akreditimit, por do të krijojë premisa për konflikt të pastër interesi, pasi i njëjti autoritet që harton kriteret dhe kushtet për pajisjen me licencë përkatëse, ushtron edhe të drejtën e vendosjes së masave administrative.
8. Humbje të pavarësisë së inspektoratit dhe konkretisht të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, pasi bie ndesh me parimet dhe kërkesat e ligjit për inspektimin.
9. Është krijuar një legjislacion unik i përbashkët dhe horizontal mbi procedurat e të gjitha fushave të inspektimit, sipas tipologjisë së tyre, dhe shbërja e tyre do të krijojë konfuzion si te trupat e inspektimit edhe tek aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces;
10. Ri-bashkimi përfshin ndryshimin strukturor të tre institucioneve, ndërkohë që Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, tashmë është inspektorat me funksione të mirëfillta inspektimi të unifikuara dhe standardizuara (me listë-verifikimi dhe dokumente standarde).
11. Është dixhitalizuar i gjithë procesi i inspektimeve dhe tashmë ato kryhen *online*, nga të gjitha degët rajonale. Për këtë, qeveria shqiptare dhe organizmat ndërkombëtare kanë financuar shuma të konsiderueshme, në infrastrukturë dhe performancë.
12. Ndryshimet e shpeshta strukturore dhe legjislative shoqërohen me kosto financiare edhe të burimeve njerëzore, sidomos këto të fundit, që kërkojnë dhe kohën e tyre për t’u profesionalizuar dhe përshtatur, në kohë relativisht të shkurtëra.
13. Janë trajnuar e ri-trajnuar të gjithë trupat inspektuese si në legjislacion dhe në përdorimin e tabletave për kryerjen e inspektimeve online;

14. Për herë të parë, metodologjia e programimit të inspektimeve ka bërë që përzgjedhja e bizneseve të bëhet bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut, dhe jo të urdhëruara sipas preferencave;
15. Ri-bashkimi do të ketë një ndikim më të drejtpërdrejtë të politikës, jo vetëm në politikë-bërjen, por edhe në dhënien e licencës, kontrollin e zbatimit të saj duke krijuar premisa për konflikt interesi, pasi i njëjti autoritet që harton kriteret dhe kushtet për pajisjen me licencë përkatëse dhe akreditimin, do të ushtrojë edhe të drejtën e inspektimit (kontrollit/verifikimit/monitorimit), si dhe vendosjen e masave administrative, duke mbledhur të gjitha pushtetet në një dorë, me plotfuqi të frikshme;
16. Ndryshimet institucionale që kërkohen, janë procese komplekse dhe jo-optimale, zbatimi i këtyre ndryshimeve mund të çojë në rezultate zhgënjyese, pasi do të ketë probleme që kanë të bëjnë me mbivendosje kompetencash, të cilat pothuajse janë drejt eliminimit në veprimtarinë inspektuese;
17. Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për mbrojtjen e shëndetit publik, zbatohen vetëm nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si i vetmi institucion, që përfshin të gjitha inspektimet në fushën e kujdesit shëndetësor dhe nuk ka konflikt interesi në vendimmarrje dhe përplasje ndërmjet fushave të licencimit dhe inspektimit.
18. Mosfunksionimin normal të inspektoratit deri në hartimin e akteve ligjore e nënligjore përkatëse, pasi domosdoshmërisht nevojiten ndryshime në legjislacionin e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale, në ligjin për inspektimin dhe të shumë akteve të tjera sektoriale në fuqi.
19. Inspektorët shtetërorë tashmë janë pjesë të shërbimit civil, me krijimin e këtyre agjencive e humbasin statusin e nëpunësit civil, dhe kthehen punonjës me Kod Pune.

Problematikat e hasura ndër vite në fushën e inspektimit, të cilat janë evidentuar dhe analizuar nga Inspektorati Qendror, tregojnë se është e rëndësishme të kërkojmë zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të cilat forcojnë veprimtarinë inspektuese, duke e përmirësuar atë dhe jo ta dobësojmë me ndryshime të shpeshta organizative, të cilat ndikojnë ndjeshëm, si në burime njerëzore ashtu dhe në zbehjen e rolit parësor të inspektimit, dhe në qasjen ndaj biznesit.

Sa më sipër, Inspektorati Qendror mendon se ky bashkim nuk do të jetë i efektshëm për arsye se bie ndesh me parimet dhe kërkesat ligjore të ligjit për inspektimin. Pra, koncepti i një Drejtorie Inspektimi pranë një Agjencie, nuk është e barasvlefshme me një inspektorat të tërë, që ka fokus kryesisht dhe profilizohet në fushën e inspektimit, pasi do të krijojë:

**Kaos**, pasi kompetencat dhe efektiviteti i veprimtarisë së ISHSH, do të kthehet në një shtojcë të një agjencie, me fokus jo vetëm veprimtarinë e inspektimit, por edhe atë të licencimit e akreditimit, pasi ndarja e funksioneve inspektuese nga ato licencuese dhe akredituese u bë si nevojë e decentralizimit të kompetencave administrative, dhe shmangies së konfliktit të interesave midis vendimmarrjes administrative në proceset e miratimit të licencave dhe akreditimit me funksionet kontrolluese e inspektuese, të cilat nga ana procedurale rregullohen tashmë nga ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

**Humbje të pavarësisë**, së Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, pasi bie ndesh me parimet e kërkesat e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht me organizimin e institucioneve publike, që kryejnë funksione inspektimi dhe mundësisë së ndërhyrjes në anën operacionale të institucionit.

**Apati**, në funksionimin normal të inspektoratit, deri në hartimin e akteve ligjore e nënligjore përkatëse, për funksionimin e kësaj agjencie, pasi domosdoshmërisht nevojiten disa ndryshime

në legjislacionin shëndetësor, në ligjin për inspektimin etj., dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të cilat kërkojnë një kohë të konsiderueshme për zbatim.

Mbështetur në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili rregullon veprimtarinë procedurale të inspektorateve, që operojnë në Republikën e Shqipërisë dhe që zbatohet nga të gjitha strukturat inspektuese, pjesë e inspektorateve, të cilat funksionojnë në nivel qendror dhe rajonal, analizojmë se *zbatueshmëria e kësaj VKM humbet objektivin dhe qëllimin e tij, pasi rregullimi i veprimtarisë së inspektimit në konceptin procedural nuk do të jetë në kushte të njëjta dhe efikase*, siç tashmë funksionon aktualisht Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (pavarësisht organizimit strukturor).

Kjo praktikë e cila është implementuar nga Inspektorati Qendror, në bashkëpunim me Inspektoratet Shtetërorë në Shqipëri, është certifikuar si “*BEST PRACTICE*” nga OECD, IGA, e Inspektorateve të vendeve më të zhvilluar të BE-së. Nga ana tjetër, kjo shkrirje - bashkim do të rrisë konfliktin e pastër të interesit, korrupsionin, klientelizmin, rritjen e shpenzimeve buxhetore, rritjen e barrës administrative ndaj biznesit dhe shumë elementë të tjerë negativë.

Përfundimisht, e kundërshtojmë miratimin e këtij draft-propozimi, pasi inspektimet do të jenë jo efektive dhe funksionale, veprimtaria e inspektimit do të shfaqet me shume problematika dhe trend negativ për të ardhmen, pasi mendojmë se nuk do të ketë gjasa për përmirësimin e gjendjes, por një vazhdim të keqësimit të situatës inspektuese, si në aspektin e funksionimit institucional, ashtu edhe në atë financiar.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

**SHKËLQIM HAJDARI**

